



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 514, datë 24.09.2024

**PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 230, DATË 26.04.2024 “PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES
TË KANDIDATËVE PËR LËVIZJE PARALELE NË GJYKATËN
ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË TIRANË, PËR POZICIONET E
LIRA TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 256, 257 DHE 258 DATË 24.05.2023
TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronja “ç”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 8, pikat 2 dhe 3, nenin 43 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun IV dhe V të vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, vendimin nr. 230, datë 26.04.2024 “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, vendimin nr. 361, datë 29.07.2024 “Për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Alban Toro”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin pjesërisht të pikës 2 të vendimit nr. 230, datë 26.04.2024 “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, nën-pika “a” si më poshtë:

Caktimin e z. Albens Tabaku si relator të këtyre procedurave të përzgjedhjes.

2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet kandidatëve të përfshirë në pikën 1 të këtij projektvendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR